www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 175

Tiranë – E martë, 15 tetor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 10.10.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"	20155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 10.10.2024	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2024 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "*Nanobalkan 2024*"	20160
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 10.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë"	20160
Urdhër i ministrit të Financave nr. 75/1, datë 4.10.2024	Për përfundimin e ngarkimit të përkohshëm/zëvendësimit në detyrë	20161
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 781, datë 4.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës	20161
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 782, datë 4.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Austrisë	20164
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 783, datë 4.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë	20166
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 784, datë 4.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës	20167

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 785, datë 4.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Suedisë.....	20169
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 786, datë 4.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	20170
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 787, datë 4.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Moldavisë....	20171
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 803, datë 9.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë....	20172
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 804, datë 9.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë....	20172
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 805, datë 9.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....	20173
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 806, datë 9.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Francës.....	20174
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 807, datë 9.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	20174
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 808, datë 9.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë.....	20176
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 809, datë 9.10.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	20176
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 17.9.2024	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mospërfundimit të gjykimit të çështjes gjyqësore administrative nr. 31112-03039-86-2020, nr. akti 14002, datë 18.11.2020 nga Gjykata Administrative e Apelit. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4789, datë 21.11.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	20177

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 14830, datë 8.10.2024	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	20184
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nr. 504 (1846), datë 18.7.2024	Për kufizimin e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Taulant Shyti.....	20185

VENDIM
Nr. 619, datë 10.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 420, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, bashkëlidhur vendimit nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", zëvendësohen me lidhjet nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i të këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2025.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 3

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi, për ushtarakët e shërbimit aktiv të personelit fluturues dhe mbështetës të fluturimeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

	Pozicioni	Masa e shtesës mujore në lekë për muaj					
		Në repartet/bazat ajrore operacionale, që kanë helikopter në TOP	Në repartet/bazat ajrore operacionale të varësisë së FAj, që kanë helikopter në TOP	Në repartet/bazat ajrore operacionale	Në komandën dhe në strukturat e tjera të Forcave Ajrore	Në Detashmentin UAV të Forcave Ajrore	Në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura
Nr.	1	2	3	4	5	6	7
1	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot Instruktor/Kontrollor Fluturimi/Pilot Kolaudator-H. Komandant/zëvendëskomandant/shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skuadron/Grup, të cilët disponojnë dëshmitë/kualifikimet/diplomën/at për ushtrimin e këtyre të drejtave.	100,000					
2	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot Instruktor/kontrollor Fluturimi-H. Komandant/zëvendëskomandant/Shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skuadron/Grup, të cilët disponojnë dëshmitë/kualifikimet/diplomën/at për ushtrimin e këtyre të drejtave.				60,000		
3	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot Komandant Ekuipazhi-H. Komandant/zëvendëskomandant/Shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skuadron/Grup, të cilët disponojnë dëshmitë/kualifikimet/diplomën/at për ushtrimin e këtyre të drejtave.	90,000			50,000		30,000
4	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot-H. Komandant/zëvendëskomandant/Shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skuadron/Grup, të cilët disponojnë dëshmitë/kualifikimet/diplomën/at për ushtrimin e		80,000		40,000		

	këtyre të drejtave.						
5	Pilot dhe Pilot UAV. Shef seksioni i kontrollit dhe standardizimit, oficer i komandimit të misionit/kontrollit të fluturimit, kontrollit të fluturimit pilot dhe standardizimit të UAV, shënjues, operator ngarkese.				30,000	45,000	25,000
6	Oficer Inxhinier aviacioni/fluturimi/helikopteri.			40,000	30,000		
7	"Anëtarë/ekuipazhi/bordi"-H. "Teknik mekanik/Aeroshpëtues/Vinçier/Navigator/Mitralier"-H.	45,000					
8	Teknik aviacioni/Helikopteri (Skuadrone/Grupet e fluturimit, në seksione dhe komandë, ushtarë/nënoficerë/oficerë). Teknik mekanik në Qendrën e Mirëmbajtjes (Specialist motori, strukturë avionike, armatim/radio/pajime elektrike/riparues helikopteri etj. -H ushtarë/nënoficerë/oficerë).			40,000	30,000	40,000	25,000
9	Kryekontrollor. Kontrollor të trafikut ajror. Kryekontrollor. Kontrollor të mbrojtjes ajrore.	40,000			30,000		
10	Ushtarakët aktivë në funksione organike për shërbimet tekniko-operacionale të radarëve të vëzhgimit të hapësirës ajrore. Funksionet organike në Qendrën e Komandimit dhe Monitorimit të Avionëve pa pilot (antidron).				30,000		
11	Mekanik/specialist/motori në strukturat avionike/armatimit. Shef qendre, specialist mekanik/motorist, specialist/elektrik/elektronik/specialist armatim-municioni dhe rezervës UAV. Specialist/analist imazherie (operator harte, navigator). Shef seksioni dhe teknik terminali të dhënash/kontrollit tokësor UAV (operator harte, navigator). Magazinier/administrator i teknikës ajrore. Teknik (motorist/mekanik/elektrik/elektronik/terminali).	25,000				25,000	
12	Në funksionet organike: - në seksionet e vend instalimit të radarit TPS-77/VQ-PRT/setet Mikrovalor/GAG. - Komandant/zëvendëskomandant reparti 3003. në komandën dhe shtabin e UAV-së.				25,000	25,000	
13	- Ndihmëskontrollor/ndihmësasistent.				20,000		
14	Në funksionet organike në pozicione mbështetëse, - në UAV; - të MNZSH (shofer autoboti, furnizim karburanti aviacioni); - në pozicione të tjera mbështetëse të strukturave të fluturimit, që nuk janë përcaktuar më sipër dhe për të cilat nuk ka përcaktime në lidhjen nr. 5, të këtij vendimi.				18,000	18,000	18,000

Shënim:

1. Funksionet organike për shërbimet tekniko-operacionale të radarëve, përcaktohen sipas specifikimeve në TOP.

2. Funksionet organike për shërbimet mbështetëse në Detashmentin UAV, në bazat ajrore dhe në struktura të tjera të Forcave të Armatosura përcaktohen sipas specifikimeve në TOP.

3. Ushtarakët aktivë në pozicionet "Pilot Komandant Ekuipazhi-H" dhe "Pilot", të emëruar në strukturat e Forcës Ajrore apo në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, shtesën e përcaktuar sipas kësaj lidhjeje e përfitojnë vetëm në rast se ruajnë gatishmërinë e fluturimit dhe normave sipas Rregullores së Zhvillimit të Fluturimeve të Forcave Ajrore.

Lidhja nr. 4

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët e shërbimit aktiv në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Nr.		Pozicioni	Masa e shtesës, (lekë në muaj)
1	Operacional	Drejtor i përgjithshëm. Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie. Përgjegjës/shef sektori. Specialist/inspektor. Specialist për sigurinë elektronike dhe mbrojtjen kibernetike. Ndihmësinspektor. Teknik i mesëm dhe administrator pajisjesh/operator. Teknik për mirëmbajtjen e pajisjeve SIGINT. Shofer autoveture, mjet operacional.	20,000
2	Operacional Mbështetës	Përgjegjës/shef sektori. Analist. Specialist. Operator dhe për administrimin e dokumentacionit. Operator radiozbulues. Operator për kartotekën, databazën dhe ekspeditor. Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme/operator/shofer. Roje me armë. Përgjegjës roje/shofer dhe roje me armë në ZGJ.	15,000
3	Mbështetës	Për ushtarakët aktivë në funksionet e tjera të AISM-së, të papërfshirë në nëndarjet 1 dhe 2, të kësaj lidhjeje.	13,000

Shënim. Pozicionet e punës në përbërje të strukturave të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas ndarjeve, operacionale, operacionale mbështetëse dhe mbështetëse, përcaktohen sipas specifikimeve në TOP.

Lidhja nr. 5

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi që përfitojnë ushtarakët e tjerë të shërbimit aktiv, në strukturat e Forcave të Armatosura

Nr.	Ushtarakë të tjerë në strukturat e Forcave të Armatosura që përfitojnë shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi	Masa e shtesës (lekë në muaj)
	1	**2**
1	Drejtor në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.	70,000
2	Specialist në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.	60,000
3	Përgjegjës sektori në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.	50,000
4	**Ushtarakët aktivë në funksionet organike**: - Komandant Qendre/komandant moduli/shef/përgjegjës sektori/seksioni në Qendrën Fikse TIK/MM dhe SHPFA, në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Komandant Qendre/Komandant moduli/shef/përgjegjës sektori/seksioni në Qendrën Mobil (TIK) në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Komandant Qendre/Komandant moduli/shef/përgjegjës sektori/seksioni në Qendrën e Automatizimit, në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Në kompanitë e aksioneve direkte në Batalionin e Forcave Speciale. - Komandant/zëvendëskomandant dhe në funksionet organike me specialitet "Polumbar" në grupin AME të zhytjes në Qendrën e Zhytjes, në Forcën Detare. - "Parashutist".	40,000
5	**Ushtarakët aktivë në funksionet organike:** - Komandant Qendre/Moduli dhe mbështetjes me SNI në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Administrator infrastrukture (për rrjetet kompjuterike të NATO-s; Web; Databazë virtualizimi; *storage back up).* - Administrator sistemesh/shërbimesh në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit.	35,000
6	**Ushtarakët aktivë të Forcës Tokësore dhe Detare, në funksionet organike:** - Në Shtabin e Batalionit të Forcave speciale. - Komandant/zëvendëskomandant/shef shtabi/shef i operacioneve dhe stërvitjes, në Regjimentin e Operacioneve Speciale. - Në Kompaninë e Zbulimit, në Regjimentin e Operacioneve Speciale. - Në kompanitë komando, në Batalionin Komando. - Në grupet e bordingut në Forcën Detare.	30,000

	- Në Seksionin e Kurseve dhe Vlerësimit, në Regjimentin e Operacioneve Speciale. - Në pozicionet "Specialist" për TIK/IT, në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në grupet/skuadrat/togat dhe kompanitë operacionale të kërkim-shpëtimit (për shuarjen e zjarreve, tërmeteve, aksidenteve, akomodimit fushor, kërkim-shpëtimit në terrene malore apo në zona ujore) në strukturat e Forcave të Armatosura.	
7	**Ushtarakët aktivë në funksionet organike:** - "Mjek me specialitet". - "Mjek i përgjithshëm": - Në kompaninë EOD në Komandën Mbështetëse; - Në togën EOD në kompaninë e Xhenios në Forcën Tokësore; - Në Qendrën e MADM-së dhe lëndëve të rrezikshme në Forcën Tokësore, si dhe në funksione të njëjta në repartet e tjera në strukturat e Forcave të Armatosura.	25,000
8	**Ushtarakët aktivë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes**: - Shef i Shtabit të Përgjithshëm; - Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm; - Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm; - Drejtor Kabineti. - Këshilltar ushtarak i Presidentit të Republikës së Shqipërisë. - Drejtor drejtorie. **Ushtarakët aktivë në funksionet organike:** - Komandant/zëvendëskomandant i Forcës Tokësore. - Komandant i Forcës Detare/i Forcës Ajrore/në Komandën e Mbështetjes, në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. - Në skuadër, togë dhe në kompanitë e këmbësorisë (manovrës)/në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në skuadër, togë dhe në kompanitë e mbështetjes me luftim, në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në Bateritë e Artilerisë Tokësore. - Në baterinë e mortajave kundërajrore në Regjimentin e Mbështetjes me Luftim në Forcën Tokësore. - Në bateritë e mbrojtjes kundërajrore, në batalionin e mbrojtjes kundërajrore të bazuar në tokë (GBAD). - Në grupet në Flotiljet Detare. - Në Shërbimin Hidrografik ushtarak, që shërbejnë në anije në Forcën Detare. - Në Kompaninë e Ceremonialit/kompaninë e transportit/grupin e sigurisë fizike/në batalionin e mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. - Në Orkestrën Frymore dhe në Orkestrën Simfonike të Forcave të Armatosura. - Në Sektorin e Mbikëqyrjes dhe Demontimit të Armatim Municionit, në Qendrën e Menaxhimit të Materialeve. - Të personelit mësimor (pedagog) pa tituj dhe grada, në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. **Ushtarakët aktivë në funksionet organike të Policisë Ushtarake:** - Komandant/zëvendëskomandant dhe Shef Shtabi. - Në sektorin e Policisë Kriminale. - Në pozicionin "agjent" dhe "inspektor" në seksionet e rretheve të Policisë Kriminale; - Në kompaninë e parë, në kompaninë e dytë operacionale dhe në kompaninë operacionale të ruajtjes së personaliteteve të larta shtetërore dhe të objekteve të veçanta. **Ushtarakët aktivë në funksionet organike:** - Stomatolog/farmacist në strukturat e Forcave të Armatosura.	20,000
9	**Ushtarakët aktivë në funksionet organike të aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura:** - Në kabinetin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm; - Në zyrën e zëvendësshefit të Shtabit të Përgjithshëm/Drejtorit të Shtabit të Përgjithshëm. Përgjegjës sektori/shef sektori/oficer shtabi/specialist dhe në funksionet/pozicionet nënoficer. **Ushtarakët aktivë në funksionet organike**: - Në Institutin e Kërkimit Shkencor Ushtarak; - Në degën e kurseve në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve; - Në Qendrën e Gjuhëve të Huaja. - Në Kursin e stërvitjes individuale bazë dhe të avancuar, në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve. **Ushtarakët aktivë në funksionet organike**: - Në kompaninë e punimeve xheniere, në kompanitë e urave, në batalionin e xhenios; - Në Detashmentin e Mbështetjes Rajonale Elbasan; - Në Kompaninë Xheniere të Regjimentit të Mbështetjes me Luftim në Forcën Tokësore, pa përfshirë togën EOD. - Personel teknik i shkencave mjekësore, në strukturat e Forcave të Armatosura.	18,000
10	**Ushtarakët aktivë në funksionet organike**: - Zëvendëskomandant force, në komandat e forcave dhe strukturave mbështetëse (FD, FAj, KM, KMS dhe AFA). - Shef shtabi/shef zyre/shef dege në komandat e forcave dhe strukturave mbështetëse (FT, FD, FAj, KM, KMS dhe AFA). - Komandant, zëvendëskomandant, shef Shtabi në regjimentet e këmbësorisë/mbështetjes me luftim, në Forcën Tokësore. - Komandant, zëvendëskomandant, shef shtabi në distriktet detare të Forcës Detare.	15,000

	- Komandant/drejtor, zëvendëskomandant/zëvendësdrejtor/kryetar/zëvendëskryetar, shef Shtabi, shef administrate, në repartet autonome të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. - Komandant reparti/zëvendëskomandant reparti/shef Shtabi reparti, në nivel batalioni/flotilje/qendre/baze në repartet e varësisë së komandave të forcave dhe strukturave mbështetëse (FT, FAj, FD, KM, AFA). - Në Batalionin komando në flotiljet detare të patrajtuara në këtë lidhje. - Në modulin e mbështetjes me SNI. - Në Qendrën fikse (TIK), (Komandant i Qendrës, Komandant i modulit SNI, moduli SNI në MM/SHP, seksioni IT dhe i shërbimeve, seksioni IT *Networks, Storage, Back-up).* - Në Qendrën fikse (TIK), (Seksioni *Servis Desk,* Seksioni i Telekomunikacionit) në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Në modulin e pikave të ritransmetimit dhe në Qendrën e Automatizimit në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Në Drejtorinë e Projekteve të Automatizimit dhe Inovacionit dhe në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes. - Në Detashmentin CIMIC të Forcës Tokësore. - Në Qendrat Stërvitore të Forcave të Armatosura. - Në seksionet e kurseve të Forcave të Armatosura.	
11	**Ushtarakët aktivë në funksionet organike**: - Shef Seksioni në Regjimentet e këmbësorisë, ROS, RML, të Forcës Tokësore, të papërfshira më sipër. - Shef seksioni në bazat ajrore të Forcës Ajrore, të papërfshira më sipër. - Shef Seksioni në Distriktet Detare të Forcës Detare, të papërfshira me sipër. - Në Qendrat Operacionale në Forcat e Armatosura. - Në kompanitë/qendrat/togat/skuadrat/e ruajtjes dhe sigurisë, në strukturat e Forcave të Armatosura. - Nënoficer i Qendrës/operator/administrator/magazinier në Qendrën fikse (TIK). - Në Seksionin e Radiostacioneve, Seksioni i Pikës së Përpunimit të Informacionit, Seksioni i Pikës së Dorëzimit të Dokumenteve, Seksioni i Monitorimit të SNI dhe Seksionin SNI Multimedia, në modulin e SNI, në MM/SHP. - pozicionet e tjera në Qendrën Mobil të TIK. - Në grupin e mirëmbajtjes së Helikopterëve në, Forcën Ajrore të papërfshira në lidhjen 3. - Në qendrat e kontrollit - raportimit, në bazat ajrore të papërfshira në lidhjen 3. - Në pozicionet "Administrator i dokumentacionit teknik/specialist dokumentacioni", në Shërbimin Meteorologjik Ushtarak. - Në bazat dhe vendbazimet detare, të Forcës Detare. - Në Qendrën e Vëzhgimit Detar të Forcës Detare. - Në Shërbimin Hidrografik dhe në Kantierin e Ndërtimit të Anijeve, të Forcës Detare. - Në kompanitë/togat/skuadrat e mbështetjes me shërbime logjistike/mbështetjes së Shtabit dhe në funksione ekuivalente - Në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në Qendrën e mbështetjes në ASNI. **Ushtarakët aktivë në funksionet organike:** - Në Qendrën e Simulimit në AFA - Në shtabet e forcave dhe strukturave mbështetëse (FT, FD, FAj, KM, KMS dhe AFA), të patrajtuara më sipër, sipas kësaj lidhjeje, në strukturat e Forcave të Armatosura. - në shtabet në nivel regjimenti, batalioni, distrikti detar, flotilje, grup, detashmenti, qendre, bazat, në strukturat e varësisë së FT, FD, FAj, KM, AFA, të patrajtuara më sipër, sipas kësaj lidhje në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në Inspektoratin e Qarkullimit Rrugor, në seksionin e rendit. - Në sektorin e MNZSH-së; - Në seksionet e rretheve/qarqeve në Policinë Ushtarake. - Në Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve, në batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. - Në kompaninë e parë dhe të dytë të furnizimit, në togat e mbështetjes, në batalionin e furnizimit të Komandës Mbështetëse. - Në kompaninë e parë dhe të dytë të transportit, në skuadrën e mirëmbajtjes në kompaninë e mbështetjes, në batalionin e transportit në Komandën Mbështetëse. - Në pozicionet me specialitete detare, të emëruar në pozicione organike, që kërkojnë kryerjen e lundrimeve, në Forcën Detare. - Në postat radioteknike dhe postave sinjal-vrojtuese, në Forcat Detare. - Në strukturat autonome të MM-së dhe SHPFA-së, të patrajtuara më sipër, sipas kësaj lidhjeje. - Në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, që nuk janë përfshirë në asnjë nivel sipas strukturave apo në nivele te tjera të kësaj lidhjeje, si dhe nuk janë të përfshirë në lidhjet nr. 3 dhe nr. 4.	13,000 13,000

Shënim:

1. Ushtarakët aktivë, funksioni i të cilëve përmban dy apo më shumë emërtime të pozicioneve të punës, që përfitojnë shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi për çdo emërtim/pozicion, do të trajtohen vetëm me një shtesë sipas kësaj lidhjeje.

2. Ushtarakët aktivë, pjesë e strukturave TIK, që trajtohen me shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi sipas kësaj lidhjeje, shtesën e përcaktuar në këtë lidhje do ta përfitojnë nëse përmbushin dy kriteret e përcaktuara në pikën 9 të këtij vendimi.

3. Në termin "Personeli teknik i shkencave mjekësore" përfshihen pozicionet e përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të personelit mjekësor dhe personelit teknik të shkencave mjekësore, në institucionet/strukturat shëndetësore në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, për mbrojtjen, për drejtësinë dhe për punët e brendshme.

VENDIM
Nr. 635, datë 10.10.2024

PËR **NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2024 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "*NANOBALKAN 2024*"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i shtohet fondi prej 12 235 653 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "*Nanobalkan 2024*", që do të organizohet në Tiranë, më datë 28 tetor 2024 deri më 1 nëntor 2024.

2. Efekti financiar, prej 12 235 653 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 636, datë 10.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 443, DATË 26.6.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR DHE PËRZGJEDHJEN E ARSIMTARËVE NË DIASPORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalia e dytë, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Ky proces realizohet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën, sipas fushës së saj të përgjegjësisë shtetërore.".

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2, 2/3, 2/4 dhe 2/5, me këtë përmbajtje:

"2/1. Në rastet kur ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën propozon organizimin e procesit mësimor në një vend, me të cilin nuk ka marrëveshje dypalëshe ndërkombëtare, planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës, zhvillimi profesional i arsimtarëve, pajisja me tekste mësimore dhe materiale ndihmëse për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë bëhet nga ministria përgjegjëse për arsimin. Përzgjedhja e arsimtarëve realizohet bashkërisht nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën, dhe ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2/2. Për rastet e parashikuara në pikën 2/1, lidhja e kontratës individuale me arsimtarin në diasporë kryhet nga kreu i misionit diplomatik të akreditуar në vendin ku ndodhet diaspora.

2/3. Pagesa e arsimtarëve në diasporë përllogaritet bazuar në numrin e orëve mësimore mujore, të përcaktuara në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, referuar pagesës së personelit vendas të misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin ku ndodhet diaspora.

2/4. Procesi mësimdhënës organizohet e realizohet nëpërmjet shoqatave kulturore, lidhjeve të mësuesve apo të shkollave shqipe, të regjistruara si organizata jofitimprurëse, në përputhje me legjislacionin e vendit ku veprojnë.

2/5. Procedura e përzgjedhjes së arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, autorizimi dhe lidhja e kontratës individuale me arsimtarin, si dhe monitorimi i mësimdhënies përcaktohen në udhëzimin e përbashkët ndërmjet ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe diasporën.".

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe diasporën, dhe ministria përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet Qendrës së Botimeve të Diasporës, mbështesin dhe inkurajojnë procesin mësimor të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë me tekste shkollore, me materiale plotësuese dhe me zhvillim profesional të arsimtarëve.".

4. Pikat 7, 9 dhe 11 shfuqizohen.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 75/1, datë 4.10. 2024

PËR PËRFUNDIMIN E NGARKIMIT TË PËRKOHSHËM/ZËVENDËSIMIT NË DETYRË

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të ligjit 8417/1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshilllit të Ministrave", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", si dhe të urdhrit nr. 609, datë 2.10.2024, të Kryeministrit "Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve",

URDHËROJ:

1. Përfundimin e ngarkimit të përkohshëm, nëpërmjet zëvendësimit në detyrën e drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve, znj. Elidjana Çelaj, zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Hartimit të Programeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, në Ministrinë e Financave, për komunikimin e këtij urdhri, si dhe znj. Elidjana Çelaj dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 781, datë 4.10.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E UKRAINËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra,

sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Chernivets'ka*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernihiv	Sribnians'kyi*	
Chernihiv	Mens'kyi*	
Chernivtsi	Hlybots'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Cherkasy	Smilians'kyi*	
Cherkasy	Cherkas'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosiïvs'kyi*	
Kiev	Rokytnians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Baryshivs'kyi*	
Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Iahotyns'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kiev	Myronivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novomyrhorods'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Oleksandriis'kyi*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Kirovohrad	Znamians'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	
Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolaivs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayiv	Bereznehuvats'kyi*	
Mykolayiv	Kryvoozers'kyi*	
Mykolayiv	Vradiivs'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Odessa	**Bilhorod-Dnistrovs'kyi***	
Poltava	Kobeliats'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	
Poltava	Poltavs'kyi*	
Poltava	**Semenivs'kyi***	
Ivano-Frankivs'k	Kolomyis'kyi*	
Sumy	Konotops'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Vinnytsya	Iampil's'kyi*	
Zaporizhzhya	**Orikhivs'kyi***	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe të embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar, për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të

shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 719, datë 18.9.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajës Afrikane të Derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 782, datë 4.10.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E AUSTRISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve.

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë***	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Vorarlberg	Bregenz	Alberschwende*
Vorarlberg	Bregenz	Eichenberg*
Vorarlberg	Bregenz	Hittisau*
Vorarlberg	Bregenz	Lochau*
Vorarlberg	Bregenz	Sulzberg*
Steiermark	Leoben	Traboch*

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me

nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

1	Středočeský	Příbram*	
2	**Plzeňský**	**Klatovy***	
3	**Jihočeský**	**Strakonice***	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 747, datë 24.9.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Çekisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 809, datë 9.10.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

d) materialit biologjik të shpendëve të pa shoqëruar me test diagnostik PCR, që vërteton mosprezencën e virusit;

e) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të *pseudopestit*, ku përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55^0C në 2.5 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55^0C në 2.3 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55^0C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës të tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57^0C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- 65^0C në 39.8 sekonda;
- 70^0C në 3.6 sekonda;
- 74^0C në 0.5 sekonda;
- 80^0C në 0.03 sekonda;

f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht,

nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	***Podlaskie***	***Mońki***	***Mońki****

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së *pseudopestit* të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 59, datë 17.9.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 17.9.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Arben Malaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë; Banka e Shqipërisë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mospërfundimit të gjykimit të çështjes gjyqësore administrative nr. 31112-03039-86-2020, nr. akti 14002, datë 18.11.2020 nga Gjykata Administrative e Apelit.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4789, datë 21.11.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi)* dhe Bankës së Shqipërisë *(BSH)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Arben Malaj *(kërkuesi)* ka kryer detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së që prej muajit dhjetor 2018 deri në muajin dhjetor 2019. Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste i përbërë nga 28 deputetë i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit përmes shkresës nr. 2790, datë 15.7.2019, me propozim për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së. Me vendimin nr. 148/2019, datë 18.12.2019 të Kuvendit "Për shkarkimin e zotit Arben Malaj nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së" *(vendimi nr. 148/2019)* kërkuesi është shkarkuar nga detyra.

2. Më datë 16.1.2020, kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 148/2019 të Kuvendit; detyrimin e të padituruës, BSH-së, që t'i paguajë pagat që do të përfitonte në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën e përfundimit të mandatit sipas ligjit; dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2392 (80-2020-2414), datë 15.10.2020, ka vendosur rrëzimin e saj si të pambështetur në ligj. Ajo ka arsyetuar se shkeljet e pretenduara nga kërkuesi në nxjerrjen e vendimit nr. 148/2019 të Kuvendit nuk justifikojnë paligjshmërinë e tij. Parashikimi ligjor për shkarkimin e tij nga detyra, sipas parashikimit të nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8269/1997)*, për shkakun e përcaktuar në shkronjën "d" të tij nuk është joproporcional dhe në shkelje të nenit 17 të Kushtetutës. Masa e shkarkimit nga detyra është e vetmja e parashikuar nga dispozita në fjalë, ndaj akti i prodhuar nga Kuvendi nuk mund të dispononte për një mjet që do të cenonte më pak interesat e kërkuesit. Gjithashtu, ajo ka argumentuar se përfitimet financiare dhe pagimi i pagës deri në përfundimin e mandatit është kërkim që rrjedh nga paligjshmëria e pretenduar e aktit të shkarkimit nga detyra, ndaj ai nuk qëndron në kushtet kur u gjykua se vendimi objekt shqyrtimi nuk duhej shfuqizuar. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkesa e posaçme për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të KPC-së, është e lidhur ngushtësisht me disponimin e gjykatës për pranimin e padisë, qoftë edhe pjesërisht. Sipas gjykatës, në kushtet kur padia ishte vlerësuar se nuk duhej pranuar, nuk ka vend as për ekzekutimin e përkohshëm të vendimit.

4. Më datë 2.11.2020, kërkuesi ka paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë të lartpërmendur. Çështja administrative nr. 31112-03039-86-2020 është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 18.11.2020 me numër akti 14002.

5. Më datë 31.8.2023, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Administrative të Apelit, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga kjo gjykatë, duke kërkuar përshpejtimin e procedurave gjyqësore për gjykimin e çështjes. Kjo kërkesë i është përcjellë Gjykatës së Lartë me shkresën nr. 1695/1 prot., datë 6.10.2023 dhe është regjistruar më datë 10.10.2023 në atë gjykatë. Në vijim, gjyqtari relator i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka konstatuar se kërkesës së kërkuesit i mungonte nënshkrimi i avokatit dhe akti i përfaqësimit, ndaj me vendimin e ndërmjetëm të datës 17.10.2023 për plotësim të

metash të kërkesës, ka vendosur t'i caktojë kërkuesit një afat 5-ditor për plotësimin e saj.

6. Më datë 20.10.2023, kërkuesi ka plotësuar të metat e kërkesës, duke e paraqitur atë në Gjykatën e Lartë së bashku me aktin e përfaqësimit të mbrojtësit të tij ligjor. Sipas kërkuesit, çështja ndodhej për gjykim prej më shumë se 2 vjetësh e gjysmë në këtë gjykatë, ndërkohë që afati i arsyeshëm, sipas nenit 399/2, shkronja "a", të KPC-së, është deri 1 (një) vit; në faqen zyrtare të kësaj gjykate nuk konstatohet ndonjë vendimmarrje për pezullim gjykimi ose veprim tjetër procedural, i cili do të mund të justifikonte shkeljen, tejzgjatjen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në fjalë, sikurse është parashikuar në nenin 399/2, shkronja "a", të KPC-së; kjo çështje administrative bën pjesë në kategorinë e çështjeve të përcaktuara në kreun II, pika 3.1 të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" (*vendimi nr. 78/2019*) të Këshillit të Lartë Gjyqësor *(KLGJ)*, për të cilën mund të ushtrohej e drejta e kërkimit për përshpejtimin e gjykimit të saj përpara Gjykatës Administrative të Apelit; tejzgjatja e afateve të gjykimit të çështjes në fjalë, pavarësisht shkakut të ngarkesës, përbën shkelje të standardeve të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*, pasi çështjet e prapambetura nuk përbëjnë arsye të vlefshme për të justifikuar tejkalimin e afatit të arsyeshëm.

7. Gjykata e Lartë ka kërkuar mendim me shkrim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila me shkresën nr. 1986/1 prot., datë 24.10.2023, ka dërguar informacionin e gjyqtarit relator për çështjen e parashtruar nga kërkuesi. Sipas gjyqtarit relator, në gjykatën e apelit çështja e kërkuesit i ka kaluar atij përmes shortit elektronik të datës 26.9.2023 dhe në dosjen gjyqësore nuk ka kërkesë për përshpejtimin e gjykimit. Ngarkesa e tij deri në atë moment ishte 2754 çështje. Po sipas tij, kërkesa për shkelje të afatit të arsyeshëm ishte paraqitur nga kërkuesi pa u plotësuar afati 30-ditor i gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, nisur ky afat nga data 26.9.2023 (data e shortit për kalimin e shqyrtimit të çështjes atij gjyqtari relator). Gjithashtu, ai ka theksuar se në rastin konkret nuk ishte shkelur afati i arsyeshëm, pasi ngarkesa e tij në çështje ishte e madhe, si dhe nuk ishte plotësuar afati 30-ditor, sipas nenit 48/2 të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4789, datë 21.11.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit për shkelje të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes administrative nga Gjykata Administrative e Apelit, me arsyetimin se nuk konstatohej zvarritje e qëllimshme e procesit nga gjyqtari relator. Sipas saj, në kuptim të nenit 399/2, pika 3, të KPC-së, si rrethanë që shkaktonte pamundësi objektive për procedim, në thelb, përbënte edhe volumi i madh i çështjeve të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë.

9. Më datë 22.2.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Me vendimin e datës 5.4.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi Gjykata Administrative e Apelit ka tejkaluar afatin e arsyeshëm në gjykimin e çështjes, e cila është regjistruar në këtë gjykatë më datë 18.11.2020 dhe ende nuk është gjykuar. Pavarësisht kësaj situate faktike, Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e tejkalimit të afatit të arsyeshëm, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, duke e bazuar vendimmarrjen e saj në pamundësinë objektive të shqyrtimit të çështjes për shkak të ngarkesës prej 2754 çështjesh gjyqësore administrative që ka në gjykim gjyqtari relator i çështjes. Gjykata Administrative e Apelit nuk rezulton që të ketë pezulluar çështjen për shkaqe ligjore ose që ajo të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, si dhe nuk janë shfaqur rrethana të pamundësisë objektive për procedim, sipas nenit 399/2, pika 3, të KPC-së. Prej kësaj gjykate nuk janë ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe efektive për rregullimin e situatës, në kushtet e tejkalimit të afatit ligjor të parashikuar në nenin 399/2, shkronja "a",

të KPC-së. Çështja që kërkohet të zgjidhet nga kjo gjykatë është specifike dhe e ndjeshme, prandaj ajo duhet ta marrë në konsideratë dhe ta zgjidhë atë sa më shpejt të jetë e mundur. Vonesa e tepërt e gjykimit të saj rrezikon efektivitetin e vetë sistemit të drejtësisë, në sytë e publikut, si dhe perceptimin e tij për dhënien e drejtësisë nga gjykata.

11. ***Subjektet e interesuara,*** Kuvendi dhe BSH-ja, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, për të cilin ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

14. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm tashmë parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijues të KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se kërkuesi, në kushtet e mungesës së një vendimmarrjeje të Gjykatës Administrative të Apelit për çështjen e tij, i është drejtuar asaj me kërkesën e datës 31.8.2023 për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit. Kjo kërkesë është përcjellë në Gjykatën e Lartë më datë 10.10.2023, dhe pas plotësimit të të metave të saj është regjistruar më datë 20.10.2023 në këtë gjykatë. Me vendimin nr. 00-2023-4789, datë 21.11.2023, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës, ndaj i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000.

16. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, Gjykata vëren se jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Gjykatës së Lartë është i datës 21.11.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur dhe regjistruar në Gjykatë më datë 22.2.2024, ndaj në këto kushte Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është tejzgjatja e procedurave gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit në gjykatën e apelit, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim në këndvështrim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka tejkaluar afatin e arsyeshëm në gjykimin e çështjes, e cila është regjistruar në këtë gjykatë më datë 18.11.2020 dhe ende nuk është gjykuar. Pavarësisht kësaj situate faktike, Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e tejkalimit të afatit të arsyeshëm, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, duke e bazuar vendimmarrjen e saj në pamundësinë objektive të shqyrtimit të çështjes për shkak të ngarkesës së çështjeve gjyqësore që ka në gjykim gjyqtari relator i çështjes. Gjykata Administrative e Apelit nuk rezulton që të ketë pezulluar çështjen për shkaqe ligjore ose që ajo të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, si dhe nuk janë shfaqur rrethana të pamundësisë objektive për procedim, sipas nenit 399/2, pika 3, të KPC-së. Prej kësaj gjykate nuk janë ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe efektive për rregullimin e situatës, në kushtet e tejkalimit të afatit ligjor të parashikuar në nenin 399/2, shkronja "a", të KPC-së. Çështja që kërkohet të zgjidhet nga kjo gjykatë është specifike dhe e ndjeshme, prandaj ajo duhet ta marrë në konsideratë dhe ta zgjidhë atë sa më shpejt të jetë e mundur.

19. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 37, datë 7.5.2024*; *nr. 21, datë 4.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, më datë 16.1.2020, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kuvendit për shkarkimin e tij nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, e, për pasojë, detyrimin për pagesën e pagave që do të përfitonte në këtë detyrë nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën e përfundimit të mandatit sipas ligjit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pambështetur në ligj. Kundër këtij vendimi, më datë 2.11.2020, kërkuesi ka paraqitur ankim. Si rezultat nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit (18.11.2020) deri në shqyrtim e saj në Gjykatë kanë kaluar pothuajse 4 vjet dhe ende nuk ka një vendimmarrje për të.

21. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes administrative, KPC-ja në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

22. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Në lidhje me *sjelljen e kërkuesit* Gjykata vëren se sikurse ka pranuar edhe Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë)* nuk konstatohet ndonjë sjellje e kërkuesit në veçanti ose e palëve në përgjithësi që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në shqyrtimin e saj në Gjykatë, nuk është kryer ndonjë veprim procedural. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që kërkuesi ose palët në proces të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

24. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes,* Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Si palë në gjykimin në shkallë të parë, krahas kërkuesit, kanë qenë Kuvendi dhe BSH-ja dhe në objektin e padisë kërkohet shfuqizimi i vendimit të Kuvendit, përmes të cilit kërkuesi është shkarkuar nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, detyrimin e BSH-së për të paguar pagat që ai do të përfitonte në këtë detyrë nga

data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën e përfundimit të mandatit sipas ligjit, si dhe dhënia e vendimit për ekzekutim të përkohshëm. Në këtë çështje gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit, i cili nëpërmjet ankimit ka vënë në lëvizje Gjykatën Administrative të Apelit. Gjykata vlerëson se, ashtu si edhe vetë Gjykata e Lartë ka çmuar (*shih paragrafin 18 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë),* çështja nuk paraqitet komplekse nga ana e saj për të justifikuar kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj.

25. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve,* Gjykata vëren se çështja e kërkuesit është në pritje për shqyrtim në gjykatën e apelit tashmë prej pothuajse 4 vjetësh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është pothuajse 5 vjet. Nga të dhënat e marra nga gjykata e apelit, çështja i është nënshtruar disa herë procedurës së rishortimit dhe më datë 12.12.2023 i ka kaluar për gjykim gjyqtares relatore N. H., e cila aktualisht ka në ngarkim 2243 çështje. Çështja e kërkuesit është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 18.11.2020, ndërkohë që aktualisht në këtë gjykatë janë në radhë për gjykim çështjet e regjistruara në vitin 2017, si dhe çështjet me përshpejtim shqyrtimi me kërkesë të palëve sipas vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së.

26. Bazuar në treguesit e mësipërm, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit lidhet me ngarkesën e lartë në gjykatën e apelit shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

27. Në këtë drejtim, Gjykata thekson në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht *(shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë *(shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuesit. Disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë " nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm", si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024, nr. 6, datë 16.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se në thelb të objektit të çështjes së kërkuesit është detyrimi për pagimin e shpërblimit që ai do të përfitonte deri në përfundimin e mandatit si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra, sipas kërkuesit, në shkelje të rëndë të ligjit, Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Në këtë drejtim konstatohet se detyra si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, sipas nenit 46 të ligjit nr. 8269/1997, nuk e pengon individin që mban këtë pozicion të kryejë njëkohësisht edhe detyra të tjera, me përjashtim të atyre që janë të papajtueshme me këtë funksion (Presidenti i Republikës, deputeti, anëtari i Këshillit të Ministrave ose punonjësi, administratori, aksionari me pjesëmarrje ndikuese në bankat e nivelit të dytë ose në subjekte që licencohen nga BSH-ja). Kjo nënkupton se aktiviteti si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së nuk mund të jetë i vetmi funksion që ai mund të ushtrojë e, për pasojë, edhe shpërblimi prej kësaj detyre nuk është i vetmi burim jetese për të.

30. Për sa më lart, me shkresën e datës 12.4.2024 kërkuesit i është kërkuar paraqitja (nëse ka) e argumenteve shtesë, ndër të tjera, për rëndësinë e saj çfarë ai rrezikon nga kohëzgjatja e procesit gjyqësor. Kërkuesi ka zgjedhur të mos paraqesë argumente shtesë në këtë drejtim. Prandaj, bazuar në argumentet e paraqitura në kërkesë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të parashtrojë shkaqe të mjaftueshme për të provuar se çështja e tij

është e një natyre të tillë që interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se çështja e tij, për shkak të natyrës që ka, lidhet me interesa *vetjakë,* por jo *jetësorë*, të tilla që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi për shkak të vonesës së gjykatës së apelit në shqyrtimin e çështjes së tij, Gjykata vlerëson se në kontekst të rrethanave të rastit, kërkuesi nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij.

31. Bazuar në këto të dhëna, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilës prej kritereve të mësipërme që janë përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, në kuptim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata çmon se çështja e tij nuk përbën shkak të arsyeshëm në aspektin kushtetues për t'u shqyrtuar me prioritet, prandaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.9.2024.
Shpallur, më 9.10.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Elsa Toska, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahimi
Anëtar kundër: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga kërkuesi Arben Malaj me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, jam kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësoj se ankimi kushtetues individual është i bazuar, ndaj, si i tillë, duhej pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Nga të dhënat e çështjes rezulton se kërkuesi ka ushtruar detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së, përreth 1 vit (dhjetor 2018 - dhjetor 2019), deri kur mbështetur në kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ai është shkarkuar nga detyra. Ai e ka kundërshtuar vendimin e shkarkimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin e datës 15.10.2020, e ka rrëzuar padinë si të pambështetur në ligj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur apel dhe çështja e tij është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 18.11.2020. Në kushtet kur çështja e tij nuk po shqyrtohej në shkallë të dytë, kërkuesi, më datë 31.8.2023, ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes (*kërkesa për përshpejtimin e procedurave*). Pasi kërkesa është përcjellë në Gjykatën e Lartë, gjyqtari relator ka konstatuar se kërkesës i mungonte nënshkrimi i avokatit dhe akti i përfaqësimit, ndaj me vendimin e ndërmjetëm të datës 17.10.2023 e ka kthyer atë për plotësim të metash. Në vijim, pas plotësimit të të metave, Gjykata e Lartë, më datë 21.11.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk konstatohej zvarritje e qëllimshme e procesit nga gjyqtari relator dhe se në kuptim të nenit 399/2, pika 3, të KPC-së, si rrethanë që shkakton pamundësi objektive për procedim, në thelb, përbënte edhe volumi i madh i çështjeve të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë. Në këto rrethana,

kërkuesi i është drejtuar Gjykatës më datë 22.2.2024 me ankim kushtetues individual.

3. Shumica pasi ka shqyrtuar kërkesën në këndvështrim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm ka vendosur rrëzimin e saj. Konkretisht, ajo ka analizuar rrethanat e veçanta të çështjes dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese duke konkluduar se: (i) në drejtim të *sjelljes së kërkuesit* nuk rezulton që ai ose palët në proces të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes (*shih paragrafin 23 të vendimit*); (ii) lidhur me *kompleksitetin e çështjes* ajo nuk është e atillë për të justifikuar kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj (*shih paragrafin 24 të vendimit*); (iii) për sa i takon *sjelljes së autoriteteve*, kohëzgjatja e gjykimit të çështjes lidhet me ngarkesën e lartë në gjykatën e apelit, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi sipas të dhënave të asaj gjykate, çështja i është nënshtruar disa herë procedurës së rishortimit dhe gjyqtarja relatore aktuale ka në ngarkim 2243 çështje, ndërsa janë në radhë për gjykim çështjet e regjistruara në vitin 2017 (*shih paragrafët 25–26 të vendimit*); (iv) në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilave të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij, pasi ndonëse çështja lidhet me interesat vetjakë ato nuk janë jetësore, në kushtet kur thelbi lidhet me detyrimin për pagimin e shpërblimit për shkak të shkarkimit nga detyra, i cili nuk është i vetmi burim jetese për kërkuesin (*shih paragrafët 29–30 të vendimit*).

4. Ndonëse bashkohem me vlerësimin e shumicës për sa u takon tre kritereve të para që lidhen me *sjelljen e kërkuesit, kompleksitetin e çështjes* dhe *sjelljen e autoriteteve*, nuk pajtohem me vlerësimin e saj për sa i përket kriterit të katërt, pra me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*.

5. Në parim jam dakord se në ndryshim nga proceset gjyqësore ku vendosen të drejta vetjake dhe tepër të rëndësishme për individin, në rastin konkret interesi thelbësor i kërkuesit në proces – kundërshtimi i shkarkimit nga detyra, *prima facie* nuk përbën interes prioritar, në kuptimin që gjykatat të kenë detyrimin të përshpejtojnë gjykimin. Megjithatë, duhet theksuar se verifikimi i rëndësisë të së drejtës materiale në procesin gjyqësor merr rëndësi dhe bëhet përcaktues në rastet kur kohëzgjatja e gjykimit, kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e autoriteteve janë të tilla që vështirësojnë nxjerrjen e një përfundimi për respektimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Përdorimi i këtij kriteri në mënyrë të veçuar dhe zbatimi i tij si faktor përcaktues në çdo rast nuk përputhet me vlerësimin "*nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret*" që ka vendosur jurisprudenca kushtetuese (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, nëse ky kriter vlerësohet në mënyrë të veçuar dhe me vlerë përcaktuese për pranimin e ankimit të individëve, atëherë rrezikohet të cenohet thelbi i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, duke e kufizuar/eliminuar atë për individët që zhvillojnë një proces gjyqësor për mbrojtjen e atyre të drejtave të ligjshme që nuk përfshihen në kategorinë e interesave prioritare.

6. Për sa më lart, çmoj se Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën për përshpejtimin e procedurave dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, duke vlerësuar edhe rrethanat që lidhen me numrin e ulët të gjyqtarëve, numrin e lartë të çështjeve dhe volumin e punës së trupit gjykues konkret në atë gjykatë.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

NJOFTIM
Nr. 14830, datë 8.10.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

"Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Gjeorgjisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar", nënshkruar më datë 18.9.2018, në Tbilisi, dhe ka hyrë në fuqi më datë 24 shtator 2024.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. 504 (1846), datë 18.7.2024, vendosi kufizimin e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Taulant Shyti, i lindur më 24.5.1988, me atësi Petraq dhe amësi Margarita, dhe caktimin si kujdestar dhe përfaqësues ligjor të tij shtetasin Ermal Shyti.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/10/15 15:40:39 +02'00'
b3b27fd65468476fb3cbf526522a47b52024101515
403175031

Çmimi 144 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)